



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister

Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistike Kosova - Kosovo Agency of Statistics



# Statistikat e Llogarive Kombëtare

## Bruto Produkti Vendor

### TM3 2022

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), përkatësisht Departamenti i Llogarive Kombëtare (DLLK), publikon të dhënat e Bruto Produktit Vendor për tremujorin e tretë të vitit 2022, sipas aktiviteteve ekonomike dhe metodës së shpenzimeve me çmime aktuale dhe me çmime të vitit paraprak.

Publikimi i BPV-së tremujore ka për qëllim që të japë një vlerësim koherent për ecurinë e ekonomisë. Metodologjia për kalkulimin e BPV-së është sipas koncepteve dhe përkufizimeve të Sistemit Evropian të Llogarive (ESA 2010). Llogaritjet e BPV-së tremujore janë në konsistencë më ato vjetore.

BPV-ja në tremujorin e tretë të vitit 2022 shënon rritje reale për 3,26% krahasuar me tremujorin e njëjtë të vitit paraprak.

**Aktivitetet ekonomike** që kishin rritje në këtë tremujor janë: Aktivitetet financiare dhe të sigurimit 12,67%; Aktivitete shkencore, profesionale dhe teknike; aktivitete të shërbimeve administrative dhe mbështetëse 8,61%; Informacioni dhe komunikimi 8,28%; Arte, argëtim dhe çlodhje, aktivitete të prodhimit të mallrave të familjeve për përdorim të vet dhe shërbime të tjera 7,49%, Tregtia me shumicë dhe me pakicë; riparimi i automjeteve dhe motoçikletave; transporti dhe magazinimi; aktivitete të akomodimit dhe shërbimit ushqimor 4,31%, Industria nxjerrëse; përpunuese; energjia elektrike, gazi, avulli dhe furnizimi me ajër; furnizimi me ujë; aktivitete të trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, rehabilitimit 7,18%; Bujqësia, pyjet dhe peshkimi 2,18%; Aktivitete të pasurive të paluajtshme 1,38%.

**Aktivitetet ekonomike** që shënuan rënie në këtë tremujor janë: Ndërtimtaria (7,78%); Administrata publike, sigurimi social, arsimit dhe shëndetësia (0,48%).

**Komponentët e BPV-së sipas metodës së shpenzimeve** që kishin rritje janë: Eksporti i mallrave dhe shërbimeve 6,24%; Importi i mallrave dhe shërbimeve 2,98%; Shpenzimet e konsumit final 3,41%.

Ndërsa rënie kishte Formimi i bruto kapitalit (2,33%).

**Shënim:**

Agjencia e Statistikave te Kosovës, përkatësisht Departamenti i Llogarive Kombëtare kanë rishikuar te dhënat e Bruto Produktit Vendor për TM3/2022 për dy arsye:

- Për shkak te rishikimit te te dhënave te Bilancit te Pagesave nga BQK, te cilat te dhëna janë publikuar pas publikimit të Bruto Produktit Vendor për TM3/2022
- Pas analizës se indeksit te çmimeve te prodhimit, i cili përdoret si deflator tek Llogaritë kombëtare, vërehet se vëllimi i prodhimit tek aktivitetit ekonomik Nace 3511 ka rritje. Ne këtë rast u vendos qe te ndryshohet ky deflator dhe te mirret indeksi i aktiviteti 3511 (Prodhimi i rrymës elektrike) për deflatim.

Bazuar në Kodin Evropian te Praktikës, Parimi 4 “Përkushtimi ndaj cilësisë”, Agjencia e Statistikave te Kosovës është e përkushtuar vazhdimisht për cilësi të të dhënave.

Te dhënat e Bruto Produktit Vendor ne baza tremujore për vitin 2022 janë te dhëna preliminare, deri ne publikimin e te dhënave vjetore për këtë periudhë, kur konsiderohen te dhëna finale.

*Shënim:* BPV tremujore sipas aktiviteteve ekonomike është paraqitur në nivelin A\*10 të agregimit sipas klasifikimit NACE Rev.2

Për të dhëna më të detajuara, klikoni në platformën ASKdata: <http://askdata.rks-gov.net/>

Fatmir Morina-Drejtor i Departamentit të Llogarive Kombëtare

Ky publikim është përgatitur nga:

Xhevdie Fetahu-Shefe e Divizionit të Llogarive Kombëtare

Nysret Sylejmani

Ylli Shala

Ilir Mazrekaj

Kaltrina Veselaj

Besim Mehmeti

Emine Bajrami

Florije Krapa

Valon Halimi

Z.v i Kryeshefit Ekzekutiv të ASK-së,

Ilir T. Berisha

Dhjetor, 2022

### **Lista e shkurtesave dhe simboleve**

- ASK - Agjencia e Statistikave të Kosovës
- BPV - Bruto Produkti Vendor
- ESA 2010 - Sistemi i Llogarive Evropiane (European System of Accounts)

## Përmbajtja

|   | Faqe |
|---|------|
| Lista e shkurtesave dhe simboleve .....   | 3    |
| Tab. 1: Bruto Produkti Vendor Tremujor.....   | 5    |
| Fig. 1 Rritja reale e BPV-së tremujore krahasuar me periudhën përkatëse të vitit paraprak ..... | 5    |
| Tab. 2 Bruto Produkti Vendor sipas aktiviteteve ekonomike me çmime aktuale.....                 | 6    |
| Tab. 3 Bruto Produkti Vendor sipas aktiviteteve ekonomike me çmime të vitit paraprak .....      | 7    |
| Tab. 4 Rritja reale e BPV-së (krahasuar me tremujorin e njëjtë të vitit paraprak).....          | 8    |
| Tab. 5 BPV tremujore sipas metodës së shpenzimeve me çmime aktuale .....                        | 9    |
| Tab. 6 BPV tremujore sipas metodës së shpenzimeve me çmime të vitit paraprak .....              | 10   |
| Tab. 7 Rritja reale e BPV-së (krahasuar me tremujorin e njëjtë të vitit paraprak).....          | 11   |
| Shpjegime metodologjike.....  | 12   |


**Tab. 1: Bruto Produkti Vendor Tremujor**

(Milionë EUR)

|                         | 2021        |              |              |             | 2022        |             |             |
|-------------------------|-------------|--------------|--------------|-------------|-------------|-------------|-------------|
|                         | I           | II           | III          | IV          | I*          | II*         | III*        |
| BPV-ja Nominale         | 1,628.5     | 1,925.6      | 2,234.0      | 2,169.7     | 1,799.2     | 2,111.4     | 2,534.8     |
| BPV-ja Reale            | 1,570.2     | 1,854.5      | 2,092.5      | 1,982.1     | 1,702.0     | 1,966.9     | 2,306.8     |
| Rritja reale e BPV-së % | <b>4.87</b> | <b>16.32</b> | <b>14.08</b> | <b>7.38</b> | <b>4.51</b> | <b>2.14</b> | <b>3.26</b> |

\* Të dhënat janë preliminare

**Fig. 1: Rritja reale e BPV-së tremujore krahasuar me periudhën përkatëse të vitit paraprak**



**Tab. 2: Bruto Produkti Vendor sipas aktiviteteve ekonomike me çmime aktuale**

(Mijëra EUR)

| Nace Rev.2  | 2021             |                  |                  |                  | 2022             |                  |                  |
|---|------------------|------------------|------------------|------------------|------------------|------------------|------------------|
|   | TM1              | TM2              | TM3              | TM4              | TM1*             | TM2*             | TM3*             |
| A Bujqësia, pyjet dhe peshkimi  | 90,785           | 153,327          | 142,430          | 164,406          | 102,857          | 161,180          | 183,287          |
| B,C,D dhe E Industria nxjerrëse; përpunuese; energjia elektrike, gazi, avulli dhe furnizimi me ajër të kondicionuar; furnizimi me ujë; aktivitetet e trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, rehabilitimit | 300,133          | 391,945          | 417,347          | 399,066          | 333,226          | 445,403          | 490,140          |
| C Nga të cilat: Industria përpunuese  | 180,094          | 258,654          | 302,826          | 284,318          | 203,530          | 305,717          | 357,154          |
| F Ndërtimtaria  | 113,842          | 172,863          | 190,608          | 198,565          | 141,005          | 180,976          | 216,962          |
| G,H dhe I Tregtia me shumicë dhe me pakicë; riparimi i automjeteve dhe motorçikletave; transporti dhe magazinimi; aktivitetet e akomodimit dhe shërbimit ushqimor   | 289,820          | 328,844          | 522,070          | 449,243          | 320,941          | 397,020          | 600,485          |
| J Informacioni dhe komunikimi   | 26,681           | 29,376           | 46,640           | 47,427           | 28,811           | 34,131           | 56,118           |
| K Aktivitetet financiare dhe të sigurimit   | 69,574           | 72,371           | 75,230           | 77,577           | 78,968           | 79,818           | 92,609           |
| L Aktivitete të pasurive të paluajtshme   | 137,004          | 131,039          | 114,675          | 129,837          | 140,434          | 135,015          | 116,494          |
| M Aktivitete shkencore, profesionale dhe teknike; aktivitete të shërbimeve administrative dhe mbështetëse   | 55,425           | 31,212           | 38,102           | 43,666           | 57,274           | 34,314           | 42,798           |
| N Administrata publike dhe mbrojtja; sigurimi social i detyrueshëm; arsimi; shëndetësia dhe aktivitete të punës sociale   | 221,199          | 219,846          | 215,542          | 236,060          | 212,461          | 220,891          | 206,966          |
| O,R,S,T and U Arte, argëtim dhe çlodhje, aktivitete të prodhimit të mallrave të familjeve për përdorim të vet dhe shërbime të tjera   | 9,392            | 11,566           | 10,955           | 10,075           | 9,554            | 12,184           | 11,593           |
| Bruto vlera e shtuar  | 1,313,855        | 1,542,389        | 1,773,600        | 1,755,922        | 1,425,531        | 1,700,931        | 2,017,451        |
| Taksat neto në produkte   | 314,659          | 383,224          | 460,440          | 413,786          | 373,658          | 410,440          | 517,306          |
| <b>Bruto Produkti Vendor</b>  | <b>1,628,514</b> | <b>1,925,614</b> | <b>2,234,040</b> | <b>2,169,708</b> | <b>1,799,189</b> | <b>2,111,371</b> | <b>2,534,757</b> |

\* Të dhënat janë preliminare

**Tab. 3: Bruto Produkti Vendor sipas aktiviteteve ekonomike me çmime të vitit paraprak**

(Mijëra EUR)

| Nace Rev.2    |   | 2021             |                  |                  |                  | 2022             |                  |                  |
|---------------|---|------------------|------------------|------------------|------------------|------------------|------------------|------------------|
|               |   | TM1              | TM2              | TM3              | TM4              | TM1*             | TM2*             | TM3*             |
| A             | Bujqësia, pyjet dhe peshkimi  | 86,778           | 142,993          | 124,643          | 131,692          | 91,804           | 156,283          | 145,537          |
| E             | Industria nxjerrëse; përpunuese; energjia elektrike, gazi, avulli dhe furnizimi me ajër të kondicionuar; furnizimi me ujë; aktivitetet e trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, rehabilitimit | 292,012          | 383,652          | 395,611          | 374,288          | 311,183          | 409,631          | 447,320          |
| B, C, D dhe E | <i>Nga të cilat: Industria përpunuese</i>   | 179,391          | 255,757          | 293,825          | 271,181          | 188,824          | 278,746          | 327,618          |
| C             | Ndërtimtaria  | 96,665           | 146,611          | 158,875          | 163,220          | 117,305          | 141,799          | 175,771          |
| F             | Tregtia me shumicë dhe me pakicë; riparimi i automjeteve dhe motorçikletave; transporti dhe magazinimi; aktivitetet e akomodimit dhe shërbimit ushqimor   | 273,868          | 312,349          | 483,798          | 410,724          | 309,523          | 370,219          | 544,566          |
| G, H dhe I    | Informacioni dhe komunikimi   | 25,372           | 27,851           | 43,565           | 43,609           | 27,398           | 31,388           | 50,503           |
| J             | Aktivitetet financiare dhe të sigurimit   | 67,832           | 71,508           | 76,390           | 78,692           | 75,616           | 77,786           | 84,758           |
| K             | Aktivitete të pasurive të paluajtshme   | 135,102          | 129,227          | 113,182          | 128,104          | 138,416          | 133,085          | 116,256          |
| L             | Aktivitete shkencore, profesionale dhe teknike; aktivitete të shërbimeve administrative dhe mbështetëse   | 55,891           | 31,443           | 37,913           | 43,192           | 56,578           | 33,827           | 41,382           |
| M dhe N       | Administrata publike dhe mbrojtja; sigurimi social i detyrueshëm; arsimi; shëndetësia dhe aktivitete të punës sociale   | 222,077          | 228,541          | 222,528          | 223,949          | 219,223          | 218,446          | 214,511          |
| O, P, dhe Q   | Arte, argëtim dhe çlodhje, aktivitete të prodhimit të mallrave të familjeve për përdorim të vet dhe shërbime të tjera   | 9,413            | 11,684           | 11,075           | 10,001           | 9,667            | 12,208           | 11,775           |
| R, S, T dhe U | Bruto vlera e shtuar  | 1,265,011        | 1,485,860        | 1,667,580        | 1,607,470        | 1,356,714        | 1,584,673        | 1,832,379        |
|               | Taksat neto në produkte   | 305,224          | 368,640          | 424,872          | 374,596          | 345,244          | 382,219          | 474,430          |
|               | <b>Bruto Produkti Vendor</b>  | <b>1,570,235</b> | <b>1,854,500</b> | <b>2,092,452</b> | <b>1,982,066</b> | <b>1,701,959</b> | <b>1,966,892</b> | <b>2,306,809</b> |
|               | <b>Rritja reale e BPV-së (%)</b>  | <b>4.87</b>      | <b>16.32</b>     | <b>14.08</b>     | <b>7.38</b>      | <b>4.51</b>      | <b>2.14</b>      | <b>3.26</b>      |

\* Të dhënat janë preliminare

Tab. 4: Rritja reale e BPV-së (krahasuar me tremujorin e njëjtë të vitit paraprak)

(%)

| Nace Rev.2                     |   | 2021        |              |              |             | 2022        |             |             |
|--------------------------------|---|-------------|--------------|--------------|-------------|-------------|-------------|-------------|
|                                |   | TM1         | TM2          | TM3          | TM4         | TM1*        | TM2*        | TM3*        |
| A                              | Bujqësia, pyjet dhe peshkimi  | -5.15       | -1.16        | -2.57        | -2.05       | 1.12        | 1.93        | 2.18        |
| B,C,D dhe E                    | Industria nxjerrëse; përpunuese; energjia elektrike, gazi, avulli dhe furnizimi me ajër të kondicionuar; furnizimi me ujë; aktivitetet e trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, rehabilitimit | 4.89        | 9.84         | 6.54         | 7.65        | 3.68        | 4.51        | 7.18        |
| C                              | <i>Nga të cilat: Industria përpunuese</i>   | 9.18        | 7.86         | 13.15        | 11.57       | 4.85        | 7.77        | 8.19        |
| F                              | Ndërtimtaria  | 3.48        | 28.48        | 1.03         | 5.54        | 3.04        | -17.97      | -7.78       |
| G,H dhe I                      | Tregtia me shumicë dhe me pakicë; riparimi i automjeteve dhe motorçikletave; transporti dhe magazinimi; aktivitetet e akomodimit dhe shërbimit ushqimor   | 4.27        | 25.95        | 29.50        | 15.03       | 6.80        | 12.58       | 4.31        |
| J                              | Informacioni dhe komunikimi   | 3.11        | 5.01         | 3.92         | 5.02        | 2.69        | 6.85        | 8.28        |
| K                              | Aktivitetet financiare dhe të sigurimit   | 3.55        | 16.90        | 8.40         | -1.87       | 8.68        | 7.48        | 12.67       |
| L                              | Aktivitete të pasurive të paluajtshme   | 2.38        | 2.02         | 3.21         | 2.36        | 1.03        | 1.56        | 1.38        |
| M dhe N                        | Aktivitete shkencore, profesionale dhe teknike; aktivitete të shërbimeve administrative dhe mbështetëse   | 5.28        | 8.84         | 10.82        | 5.97        | 2.08        | 8.38        | 8.61        |
| O,P, dhe Q                     | Administrata publike dhe mbrojtja; sigurimi social i detyrueshëm; arsimit; shëndetësia dhe aktivitete të punës sociale  | 11.56       | 1.38         | 1.65         | -6.18       | -0.89       | -0.64       | -0.48       |
| R,S,T dhe U                    | Arte, argëtim dhe çlodhje, aktivitete të prodhimit të mallrave të familjeve për përdorim të vet dhe shërbime të tjera   | 7.00        | 4.88         | 5.55         | 3.08        | 2.92        | 5.54        | 7.49        |
| <b>Bruto vlera e shtuar</b>    |   | 4.63        | 11.23        | 10.02        | 5.07        | 3.26        | 2.74        | 3.31        |
| <i>Taksat neto në produkte</i> |   | 5.88        | 42.64        | 33.44        | 18.55       | 9.72        | -0.26       | 3.04        |
| <b>Bruto Produkti Vendor</b>   |   | <b>4.87</b> | <b>16.32</b> | <b>14.08</b> | <b>7.38</b> | <b>4.51</b> | <b>2.14</b> | <b>3.26</b> |

\* Të dhënat janë preliminare



Tab. 5: BPV tremujore sipas metodës së shpenzimeve me çmime aktuale

(Mijëra EUR)

| Komponentet e BPV-së sipas metodës së shpenzimeve               | 2021             |                  |                  |                  | 2022             |                  |                  |
|---|------------------|------------------|------------------|------------------|------------------|------------------|------------------|
|   | TM1              | TM2              | TM3              | TM4              | TM1*             | TM2*             | TM3*             |
| Shpenzimet e konsumit final                                     | 1,666,853        | 1,918,487        | 1,812,376        | 2,231,411        | 1,943,135        | 2,144,860        | 2,068,479        |
| Shpenzimet e konsumit final të ekonomive shtëpiake dhe IJPSHESH | 1,422,051        | 1,665,823        | 1,578,582        | 1,938,305        | 1,710,116        | 1,893,682        | 1,837,238        |
| Shpenzimet e konsumit final të Qeverisë                         | 244,801          | 252,663          | 233,794          | 293,105          | 233,019          | 251,177          | 231,241          |
| Formimi I bruto kapitalit                                       | 534,160          | 763,841          | 744,827          | 818,123          | 621,724          | 765,382          | 865,886          |
| Exporti neto  | (572,499)        | (756,714)        | (323,163)        | (879,825)        | (765,670)        | (798,870)        | (399,609)        |
| Exporti i mallrave dhe shërbimeve                               | 416,662          | 502,867          | 1,166,930        | 572,202          | 592,948          | 733,255          | 1,421,035        |
| Exporti i mallrave  | 152,608          | 191,692          | 198,610          | 209,771          | 217,814          | 233,658          | 244,797          |
| Exporti i shërbimeve  | 264,054          | 311,174          | 968,320          | 362,431          | 375,133          | 499,598          | 1,176,238        |
| Importi i mallrave dhe shërbimeve                               | 989,160          | 1,259,581        | 1,490,093        | 1,452,027        | 1,358,618        | 1,532,125        | 1,820,644        |
| Importi i mallrave  | 849,370          | 1,062,505        | 1,177,602        | 1,230,251        | 1,157,544        | 1,267,467        | 1,400,168        |
| Importi i shërbimeve  | 139,791          | 197,075          | 312,491          | 221,776          | 201,074          | 264,658          | 420,476          |
| <b>Bruto Produkti Vendor</b>                                    | <b>1,628,514</b> | <b>1,925,614</b> | <b>2,234,040</b> | <b>2,169,708</b> | <b>1,799,189</b> | <b>2,111,371</b> | <b>2,534,757</b> |

\* Të dhënat janë preliminare

Tab. 6: BPV tremujore sipas metodës së shpenzimeve me çmime të vitit paraprak

(Mijëra EUR)

| Komponentet e BPV-së sipas metodës së shpenzimeve               | 2021             |                  |                  |                  | 2022             |                  |                  |
|---|------------------|------------------|------------------|------------------|------------------|------------------|------------------|
|   | TM1              | TM2              | TM3              | TM4              | TM1*             | TM2*             | TM3*             |
| Shpenzimet e konsumit final                                     | 1,624,438        | 1,808,504        | 1,760,615        | 2,002,848        | 1,807,605        | 1,964,569        | 1,874,148        |
| Shpenzimet e konsumit final të ekonomive shtëpiake dhe IJPSHESH | 1,378,641        | 1,547,030        | 1,519,733        | 1,723,851        | 1,570,409        | 1,719,018        | 1,639,135        |
| Shpenzimet e konsumit final të Qeverisë                         | 245,797          | 261,474          | 240,882          | 278,997          | 237,196          | 245,552          | 235,012          |
| Formimi I bruto kapitalit                                       | 503,489          | 673,940          | 654,928          | 671,973          | 542,538          | 635,436          | 727,457          |
| Exporti neto  | (557,692)        | (627,944)        | (323,091)        | (692,755)        | (648,184)        | (633,114)        | (294,795)        |
| Exporti i mallrave dhe shërbimeve                               | 413,657          | 506,464          | 1,115,060        | 561,602          | 565,569          | 683,978          | 1,239,730        |
| Exporti i mallrave  | 149,554          | 189,908          | 180,960          | 199,908          | 204,280          | 217,843          | 223,772          |
| Exporti i shërbimeve  | 264,103          | 316,556          | 934,100          | 361,694          | 361,289          | 466,135          | 1,015,958        |
| Importi i mallrave dhe shërbimeve                               | 971,348          | 1,134,409        | 1,438,152        | 1,254,357        | 1,213,753        | 1,317,092        | 1,534,525        |
| Importi i mallrave  | 828,222          | 938,797          | 1,123,933        | 1,037,723        | 1,019,205        | 1,073,071        | 1,161,281        |
| Importi i shërbimeve  | 143,127          | 195,612          | 314,219          | 216,634          | 194,548          | 244,020          | 373,244          |
| <b>Bruto Produkti Vendor</b>                                    | <b>1,570,235</b> | <b>1,854,500</b> | <b>2,092,452</b> | <b>1,982,066</b> | <b>1,701,959</b> | <b>1,966,892</b> | <b>2,306,809</b> |

\* Të dhënat janë preliminare

Tab. 7: Rritja reale e BPV-së (krahasuar me tremujorin e njëjtë të vitit paraprak)

(%)

| Komponentet e BPV-së sipas metodës së shpenzimeve               | 2021        |              |              |             | 2022        |             |             |
|---|-------------|--------------|--------------|-------------|-------------|-------------|-------------|
|   | TM1         | TM2          | TM3          | TM4         | TM1*        | TM2*        | TM3*        |
| Shpenzimet e konsumit final                                     | 8.90        | 10.02        | 2.96         | 8.51        | 8.44        | 2.40        | 3.41        |
| Shpenzimet e konsumit final të ekonomive shtëpiake dhe IJPSHESH | 6.94        | 10.34        | 2.73         | 9.21        | 10.43       | 3.19        | 3.84        |
| Shpenzimet e konsumit final të Qeverisë                         | 21.38       | 8.16         | 4.49         | 4.35        | -3.11       | -2.81       | 0.52        |
| Formimi I bruto kapitalit                                       | 13.25       | 34.54        | 0.35         | 1.20        | 1.57        | -16.81      | -2.33       |
| Exporti i mallrave dhe shërbimeve                               | 8.95        | 120.69       | 145.20       | 38.60       | 35.74       | 36.02       | 6.24        |
| Exporti i mallrave  | 52.40       | 65.24        | 52.78        | 39.21       | 33.86       | 13.64       | 12.67       |
| Exporti i shërbimeve  | -6.19       | 176.31       | 177.76       | 38.26       | 36.82       | 49.80       | 4.92        |
| Importi i mallrave dhe shërbimeve                               | 18.66       | 45.46        | 46.27        | 17.33       | 22.71       | 4.57        | 2.98        |
| Importi i mallrave  | 22.05       | 39.49        | 41.60        | 14.93       | 20.00       | 0.99        | -1.39       |
| Importi i shërbimeve  | 2.24        | 83.09        | 65.85        | 30.35       | 39.17       | 23.82       | 19.44       |
| <b>Rritja reale e BPV-së</b>                                    | <b>4.87</b> | <b>16.32</b> | <b>14.08</b> | <b>7.38</b> | <b>4.51</b> | <b>2.14</b> | <b>3.26</b> |

\* Të dhënat janë preliminare

## Shpjegime metodologjike

### 1. Mbulueshmëria

Përlogaritjet përfshijnë të gjitha aktivitetet në bazë të koncepteve të Sistemit Evropian të Llogarive (ESA 2010).

### 2. Burimet e të dhënave

Vlerësimi i Llogarive Kombëtare Tremujore bazohet në burimet e disponueshme të të dhënave të LLK vjetore. Burimet kryesore të të dhënave përfshijnë: burime statistikore dhe burime administrative.

#### *Burimet e të dhënave statistikore*

- Indeksi i çmimeve të prodhimit (IÇP);
- Indeksi i harmonizuar i çmimeve të konsumit (IHÇK);
- Indeksi i çmimeve të importit (IÇIMP);
- Indeksi i çmimeve të inputeve bujqësore;
- Indeksi i çmimeve të prodhimit bujqësor;
- Të dhënat e tregtisë së jashtme: importi dhe eksporti i mallrave;
- Statistikat e hotelarisë (numri i vizitorëve dhe numri i netëve);
- Statistikat e energjisë; o Anketa e Fuqisë Punëtore;

#### *Burimet e të dhënave administrative*

Burimet e të dhënave administrative të përdorura për vlerësimin e BPV-së tremujore janë:

- Të dhënat mujore të njësive jo-financiare të marra nga Administrata Tatimore e Kosovës (të dhënat mujore lidhur me qarkullimin, pagat, kontributet për sigurime shoqërore, numri i të punësuarve, blerjet dhe shpenzimet);
- Të hyrat dhe shpenzimet e qeverisë në baza mujore;
- Pasqyrat financiare të Bankës Qendrore, bankave komerciale dhe kompanive të sigurimit;
- Të dhënat në baza mujore për bilancin e pagesave nga Banka Qendrore e Kosovës etj.

### 3. Metoda e vlerësimit

Llogaritë kombëtare tremujore janë në konsistencë me ato vjetore dhe janë të bazuara në të njëjtat koncepte, parime dhe strukturë.

### 4. Paraqitja e të dhënave

Të dhënat kryesore dhe kategoritë e paraqitura janë sipas koncepteve dhe terminologjisë së harmonizuar të ESA 2010. Të dhënat sipas aktiviteteve janë paraqitur sipas Klasifikimit statistikor të Aktiviteteve Ekonomike të Bashkësisë Evropiane (NACE Rev.2). Të dhënat në baza tremujore janë paraqitur në tabelat në vijim me çmime aktuale dhe si matje e vëllimit me çmime të vitit paraprak.

## 5. Përkufizime

**Bruto Produkti Vendor** - Treguesi më i rëndësishëm ekonomik në Sistemin e Llogarive Kombëtare është Bruto Produkti Vendor (BPV), i cili paraqet performancën e ekonomisë së një shteti në një periudhë të caktuar kohore. Bruto Produkti Vendor me qasjen e prodhimit është i barabartë me vlerën e shtuar sipas aktiviteteve me çmime bazë, e rritur me tatimet mbi produkte, dhe të zvogëluar për vlerën e subvencioneve në produkte.

Në këtë mënyrë Bruto Produkti Vendor është i barabartë 9 me shumën e vlerës së shtuar me çmime bazë të të gjitha njësive të prodhimit të një vendi (rezidentë) dhe tatimeve neto në produkte (tatimet minus subvencionet mbi produkte).

### **BPV=BVSH+TP-SP**

BPV = Bruto produkti vendor (me çmimet e tregut)

BVSH = Bruto vlera e shtuar (me çmimet bazë)

TP = Tatimet ne produkte

SP = Subvencionet në produkte

**Konsumi i ndërmjetëm** është vlera e përgjithshme e mjeteve të përdorura, konsumuara apo të transformuar gjatë procesit të prodhimit.

**Vlera e shtuar bruto** me çmime bazë është e barabartë me Outputin me çmimet bazë, të zvogëluar për konsumin e ndërmjetëm me çmime blerëse.

**Çmim bazë** Shuma që prodhuesi merr nga blerësi për njësi të produktit apo shërbimit të prodhuar, pa tatimet dhe subvencionet mbi produktin. Çmimi bazë përjashton shpenzimet e transportit të faturuara më vete.

**Çmim tregu** Është çmimi bazë pasi shtohen taksat mbi produktet minus subvencionet mbi produktet.

**Çmime aktuale** Çmimet e periudhës referuese. Ato përfaqësojnë çmimin e paguar për të mirat dhe shërbimet në kohën e prodhimit ose të konsumit.

**Çmime konstante** Çmime konstante janë në vlerë reale pra të korrigjuara për ndryshimet në çmime në lidhje me një vit bazë. Ato janë një mënyrë për të matur ndryshimin real në prodhim.

### **Konsumi final i ekonomive shtëpiake**

Ky transaksion është regjistruar sipas çmimeve blerëse dhe përbëhet nga shpenzimet e ekonomisë familjare për të gjitha mallrat dhe shërbimet, me përjashtim të shpenzimeve për banim, të cilat konsiderohen si formim i bruto kapitalit fiks të pronarit. (Megjithatë, qiratë e objekteve dhe banesave klasifikohen si konsum final i shpenzuar nga ekonomia familjare).

### **Konsumi final nga institucionet qeveritare dhe Jo-fitimprurëse**

Shpenzimet e bëra nga dy sektorët e fundit mund të ndahen në dy kategori: individuale dhe kolektive. E para përbën shpenzimet e bëra për përfitime individuale, p.sh. shërbimet mjekësore.

Shpenzimet kolektive kanë karakter publik, për shembull shpenzimet qeveritare në mbrojtjen dhe sigurinë publike do të përfshiheshin në këtë kategori.

---

### **Formimi i bruto kapitalit**

Kjo tërësi paraqitet në llogaritë kapitale të llogarive kombëtare dhe në raportin mbi veprimtaritë qeveritare. Është njëra nga dy transaksionet kryesore në pasuritë kapitale. Siç nënkuptohet nga emri, në formimin e bruto kapitalit fiks paraqiten të gjitha marrjet dhe posedimi i pasurive fikse, që do të thotë se të gjitha pasuritë e prodhuara, janë të natyrës jo financiare dhe janë transferuese ndërmjet njësive prodhuese. Pasuritë kapitale mund të jenë të prekshme – p.sh. ndërtesat, objektet, makineria – ose jo të prekshme – p.sh. softuerët kompjuterik. Ngjashëm me konsumin, ky transaksion vlerësohet sipas çmimeve blerëse.

- **Adresa: AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS,**  
Rr. "Zenel Salihu", nr. 4, 10000 Prishtinë
- **Telefoni:** +383 (0) 38 200 31 129  
Kryeshefi Ekzekutiv: +383 (0) 38 200 31 112
- **Fax:** +383 (0) 38 235 033
- **E-mail:** [infoask@rks-gov.net](mailto:infoask@rks-gov.net)
- **Ueb-faqe:** <http://ask.rks-gov.net>
- © : Agjencia e Statistikave të Kosovës,
- Riprodhimi autorizohet nëse tregohet burimi.